

BPrAL Kolegji Heimerer Prishtinë

**RREGULLORE PËR DIPLOMIMIN E STUDENTËVE TË
BPrAL KOLEGJI HEIMERER**

**Prishtinë
Dhjetor 2021**

BPrAL kolegji-heimerer		
PrBHE college-heimerer		
Nr. Prot:	Data:	
Prot. No: 205121	Date: 10/12/2021	
Njësia: 4		Prishtinë

Në bazë të Statutit të BPrAL Kolegji-Heimerer, sipas propozimit të Këshillit Akademik të datës 07.12.2021, Rektorija e BPrAL Kolegji-Heimerer, me datë 08.12.2021 miratoi plotësimet dhe ndryshimet e Rregullores për Diplomim të miratuar më datë 10.10.2019:

RREGULLORE PËR DIPLOMIMIN E STUDENTËVE NË BPrAL KOLEGJI HEIMERER
(Teksi i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 131 të Këshillit Akademik, datë 07.12.2021)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat e punimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës për studimet e niveleve Bachelor dhe Master si dhe lëshimi i diplomës për studentët e diplomuar të Bartësit Privat të Arsimit të Lartë Kolegji-Heimerer, Prishtinë, (BPrAL Kolegji-Heimerer).

Neni 2

- 2.1. Kohëzgjatja e studimeve themelore Bachelor është tre (3) vite (180 ECTS), kohëzgjatja e studimeve Master është dy (2) vite (120 ECTS);
- 2.2. Për të fituar titullin përkatës shkencor/profesional, studenti duhet të punoj temën e diplomës për studimet e nivelit Bachelor/Master/MA;
- 2.3. Pas plotësimit të parakushteve të studimeve themelore në Bachelor dhe Master, studentët duhet të punojnë temën Bachelor/Master/MA, për të fituar kualifikimin përkatës përmes procedurës si më poshtë:
 - 2.3.1. Studenti temën e diplomës BSc, MSc dhe MA duhet t'a paraqesë përmes platformës elektronike SIMS. Tema e diplomes mund të paraqitet me minus tre provime të vitit të fundit të studimeve, duhet përfunduar të gjitha provimet e viteve paraprake.
 - 2.3.2. Studenti ka të drejtë të ndërroj temën dhe mentorin një herë, me këtë rast studenti obligohet të lajmëroj mentorin, dekanatin dhe departamentin e diplomave, dhe pas kësaj në formularin e ndryshimit të temës ose mentorit shënohen detajet e ndryshimeve;
 - 2.3.3. Tema e lejuar duhet të mbrohet me afat prej 12 muaj. Koha minimale për mbrojtjen e temës nga paraqitja e saj duhet të jetë jo më pak se tre muaj për studimet bachelor (BSc) dhe katër

muaj për studimet Master (Msc/Ma). Nëse nuk arrihet ky afat atëherë tema e lejuar anulohet dhe studenti duhet të zgjedh temën e re.

- 2.3.4. Afati nga paragrafi 2.3.3 i këtij Neni mund të shtyhet nëse plotësohen kushtet për pezullim të statusit të studentit, siq parashihen në Statutin e BPrAL Kolegji Heimerer.
- 2.3.5. Studenti përgatitë kërkesën për inicim të paraqitjes së temës së diplomës, propozon Mentorin e temës, si dhe në dakordim me mentorin e propozuar përgatitë draftin e projekt propozimit të temës së diplomës (shih dokumentin përkatës), dhe gjitha këto të kompletuara i dërgon sipas procedurave administrative përkatëse.
- 2.3.6. Shërbimi Studentor në afat kohorë prej 48 orëve (2 ditë të punës) e shqyrton dokumentacionin e studentit, këtij dokumentacioni i'a bashkangjet edhe kartelen e studentit dhe e dërgon tek Departamenti i Diplomave.
- 2.3.7. Në rast se Departamenti i Diplomave has në dokumentacion që nuk plotëson kriteret për diplomim, atëherë kjo zyrë i kthen dokumentet gjegjëse tek Shërbimi Studentor bashkë me arsyen dhe këshillat përkatëse bazuar në rregulloret në fuqi, kurse Shërbimi Studentor duhet të informoj studentin për kriteret e pa arritura për diplomim dhe për hapat e mëtejme.
- 2.3.8. Në rastin kur dokumentacioni plotëson kriteret e përcaktuara për inicim të temës së diplomës, departamenti i diplomave në afat kohor prej 5 ditë pune dërgon pranë Dekanatit përkatës dosjen ¹ e studentëve që plotësojnë kriteret e paraqitjes së temës së diplomes.
- 2.3.9. Dekanati pasi pranon dosjet e lartë përmendura bashkë me dokumentacionin përkatës, shqyrton këtë dokumentacion në mbledhjen e Këshillit në nivel dekanati, ku vlerëson arritjen e kriterit të projekt propozimit të temës përkatëse: tema me qenë hulumtuese (Studim rasti, eksperimentale, studime longitudinale, hulumtime kuantitative dhe kualitative e të tjera, systematic revieë etj.), të fushës së studimit. Po ashtu dekanati propozon Mentorin e temës dhe dy anëtarë tjerë të komisionit (kryetarin dhe anëtarin tjetër të komisionit) dhe në afat kohor prej më së voni 48 orë para mbajtjes së takimit të Këshillit Akademik, dërgon dokumentacionin përkatës pranë të njëjtit.
- 2.3.10. Në rast se dokumentacioni i studentit nuk plotëson kriteret e kërkuara për projekt propozim të diplomës, atëherë Dekanati kthen dokumentacionin tek Departamenti i Diplomave me arsyetimin përkatës sipas rregullave në fuqi.
- 2.3.11. Këshilli Akademik sipas afateve të përcaktuara me Statut dhe Rregulloren e punës së Këshillit Akademik organizon mbledhje bashkë me Dekanatet, ku shqyrtojnë kërkesat për aprovim të temës së diplomës apo për mbrojtje të së njëjtës. Nëse dokumentacionet përkatëse plotësojnë kriteret e përcaktuara, atëherë Këshilli Akademik me vendim miraton: listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, draft propozimin për temë, Mentorin e temës dhe antarët e komisionit.
- 2.3.12. Këshilli i Dekanatit ka të drejtë të bëjë ndryshimet e nevojshme në emërimin e Mentorit dhe anëtarëve të komisionit edhe pas datës së aprovimit të tyre nga Këshilli Akademik, duke ofruar arsyetimi të bazuar për një ndryshim të tillë në takimin e rradhës të Këshillit Akademik.
- 2.3.13. Në rast të ndonjë parregullësie, Këshilli Akademik do të kthej dokumentacionin përkatës tek Dekanati dhe jep arsyetim dhe këshilla relevante konform rregulloreve në fuqi.

¹ Kartela e studentit, certifikata e notave, projekt propozimi i temes së diplomes, formulari për diplomim.

- 2.3.14. Vendimet për aprovim të projekt propozimit për temë të diplomës të nxjerra nga Këshilli Akademik në formë të shkruar dërgohen tek Dekanatet përgjegjëse dhe tek Departamenti i Diplomave. Ndërkaq Departamenti i Diplomave njofton studentët për vendimet e aprovuara dhe hapat e mëtejshëm.
- 2.3.15. Mentori i temës ka për obligim të takoj studentin pesë (5) herë (duke përfshi edhe konsultimet online). Mentori i temës është mbështetës për mbarrvajtjen e punimit të diplomës. Studenti ka për obligim të njoftoj Mentorin e temës për detajet e ndryshme të temës dhe procedurave përkatëse, dhe se duhet të marr aprovimin nga Mentori, dhe përmes mentorit nga komisioni për procedurat e mëtejshme.
- 2.3.16. Në rast se Mentori i temës së bashku me anëtarët e komisionit, vlerësojnë se tema e aprovuar ka nevojë për ndryshime përmbajtësore, atëherë kanë të drejtën e aplikimit të këtyre ndryshimeve me kusht që të njejtat të paraqiten në takimin e radhës së Këshillit Akademik.
- 2.3.17. Pas aprovimit të projekt propozimit nga KA, studenti përgatitë në detaje hyrjen, shqyrtimin e literatures dhe metodologjinë, dhe pas kësaj, dorëzon tek Mentori i cili duhet të ndaë këtë version me anëtarët e komisionit dhe vetëm pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga anëtarët e komisionit dhe dakordimit me mentorin, studenti mund të dal në teren për mbledhjen e të dhënave.
- 2.3.18. Pas përfundimit të temës dhe hulumtimit, studenti dërgon temën e kompletuar tek Mentori, i cili shqyrton atë bashkë me komisionin dhe në periudhën kohore tre javore dërgon komentet/sugjerimet eventuale tek studenti.
- 2.3.19. Me aprovimin e temës nga Mentori dhe Komisioni, kur të njejtat kanë dyshime për plagjiaturë, atëherë tema dërgohet tek departamenti i diplomave, i cili ka për obligim t'a procedojë atë për kontrollë kundër plagjiaturës. Personi përgjegjës për kontrollën kundër plagjiaturës harton raportin nëse tema e propozuar ka kaluar me sukses testimin. Nëse raporti kalon me sukses testimin antiplagjiaturë atëherë personi përgjegjës dërgon raportin e njejtë tek departamenti i diplomave. Tutje, Shërbimi studentor nxjerr kartelen e studentit, e cila duhet të përmbajë të gjitha provimet e përfunduara dhe të njejtën e dërgon tek departamenti i diplomave.
- 2.3.20. Në rast se departamenti i diplomave hasë në raport pozitiv Antiplagjiat, këtë raport e kthen tek studenti, Mentori dhe anëtarët e Komisionit. Studenti, nën mbikqyrjen e mentorit duhet të punojë në drejtim të evitimit të defekteve të dalura nga raporti kundër plagjiaturës.
- 2.3.21. Pas plotësimit të dokumentacionit, kërkesa për lejim të mbrojtjes finale të temës procedohet fillimisht pranë Këshillit të Dekanatit për aprovim. Pas aprovimit nga Këshilli i Dekanatit procedohet për miratim pranë Këshillit Akademik nga ana e Dekanatit përkatës. Në takimin e Këshillit Akademik mirret vendim për aprovim, refuzim apo plotësim të temës së diplomës. Në rast të vendimit refuzues apo plotësues, Këshilli Akademik duhet ofruar arsyetim të bazuar. Ndërkaq në rast të aprovimit për mbrojtje finale të temës së diplomës, mbrojtja duhet të bëhet më së largu brenda tridhjetë (30) ditëve nga nxjerrja e vendimit të Këshillit Akademik.
- 2.3.22. Mentori në dakordim me anëtarët e komisionit përkatës caktojnë datën e mbrojtjes dhe lajmërojnë Dekanatin përkatës dhe Departamentin e Diplomave të cilët kanë për obligim të lajmërojnë studentin për datën e mbrojtjes dhe procedurat e mëtejshme.

2.3.23. Në përfundim të studimeve, studentët që diplomojnë, fitojnë titullin përkatës nga lëmia që kanë studiuar.

II. Kriteret dhe kufizimet për përcaktim të Mentorit dhe Co-Mentorit

Neni 3

Të drejtën për të qenë Mentor të temës e kanë:

- 3.1. Mësimdhënësit që kanë njohuri për fushat profesionale që mbulon programi i studimeve, metodat e hulumtimit, shkrimin akademik dhe për softveret e ndryshëm për analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve. Në të kundërtën duhet caktuar co-mentor nga fusha specifike.
- 3.2 Mësimdhënësit që kanë njohuri për rregulloret në fuqi të Kolegjit Heimerer, posaçërisht për Rregulloren e Studimeve, Diplomimit, Statutin e Kolegjit heimerer, udhëzuesin dhe format për temat e diplomës të Kolegji Heimerer.
- 3.3 Mësimdhënësit me performancë të mire.
- 3.4 Mësimdhënësit me nivel shkollimi më të lartë se sa niveli i studimeve ku kërkohet mentorimi, respektivisht:
 - a) Mësimdhënësi me gradë shkencore Msc/MA mund të caktohet Mentor për temat e propozuara në nivelin Bachelor.
 - b) Mësimdhënësi me gradë shkencore Ph.D. mund të caktohet Mentor për temat e propozuara në nivelin Master.
- 3.5 Në raste të veçanta edhe *profesor emeritus*, mund të propozohet për Mentor, i cili titullin profesor emeritus e ka marrë para se ti caktohet mentorimi. Vendimin për këtë e merr Këshilli Akademik me propozim të Dekanit të programit.
- 3.6 Mësimdhënësit të cilët nuk kanë konflikt interesi, të përcaktuar tek dispozita e “Konfliktit të Interesit”.
- 3.7 Mësimdhënësit të cilëve përkundër që u është ndërprerë kontrata e punës dhe/ose largohen nga institucioni për arsye të caktuara. Me këtë rast kërkohet marrëveshje dhe pëlqim nga të dy palët dhe aprovim nga Dekanati dhe KA.

Neni 4

Të drejtën për të qenë Co-Mentor të temës e kanë:

- 4.1. Mësimdhënësit që kanë njohuri për fushat profesionale që mbulon programi i studimeve, metodat e hulumtimit, shkrimit akademik dhe për softveret e ndryshëm për analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve.
- 4.2 Mësimdhënësit që kanë njohuri për rregulloret në fuqi të Kolegjit Heimerer, posaçërisht për Rregulloren e Studimeve, Diplomimit, Statutin e Kolegjit Heimerer, udhëzuesit dhe format për temat e diplomës të Kolegjit Heimerer.
- 4.3 Mësimdhënësit me nivel shkollimi më të lartë se sa niveli i studimeve ku kërkohet co-mentorimi, respektivisht:
 - a) Mësimdhënësi me gradë shkencore Msc/MA mund të caktohet co-mentor për temat e propozuara në nivelin Bachelor.
 - b) Mësimdhënësi me gradë shkencore Ph.D. mund të caktohet co-mentor për temat e propozuara në nivelin Master.
- 4.4 Mësimdhënësi nga fusha shkencore nga e cila përgatitet tema e diplomës ose të paktën të mbuloj një fushë specifike relevante që është pjesë e hulumtimit.
- 4.5 Mësimdhënësit të cilët nuk kanë konflikt interesi, të përcaktuar tek dispozita e konfliktit të interesit.
- 4.6 Mësimdhënësit të cilëve përkundër që u është ndërprerë kontrata e punës dhe/ose largohen nga institucioni për arsye të caktuara. Me këtë rast kërkohet marrëveshje dhe pëlqim nga të dy palëtve dhe aprovim nga Dekanati dhe KA.

Neni 5

Kufizimet për caktim të Mentorëve

- 5.1. Për të siguruar cilësi të punimit të Diplomës, një Mentor mund të angazhohet njëkohësisht:
 - a) Në programet e nivelit Bachelor: në më së shumti 10 tema si Mentor dhe të përcjellë 10 të tjera të propozuara si anëtar Komisioni;

ose
 - b) Në programet e nivelit Master: në më së shumti 5 tema si Mentor dhe të përcjellë 5 të tjera të propozuara si anëtar Komisioni.

- 5.2 Angazhimi i mentorëve sipas pikës 5.1 të këtij neni mund të bëhet njëkohësisht për të dy nivelet e studimeve, pa tejkaluar kuotën, përkatësisht limitin e numrit të temave të përcaktuara.
- 5.3 Përjashtimit nga kufizimet e pikës 5.1 dhe 5.2 të këtij neni, mentorët me marrëveshje me Dekanatin përkatës dhe aprovim nga Rektorati, mund të angazhohen në më shumë tema se kufizimet e lartëcekura.
- 5.4 Për Mentor nuk mund të propozohet profesori i pensionuar, i cili nuk ka marrë paraprakisht titullin Profesor emeritues. Para se të marrë detyrën e mentorit për herë të parë, secili mentor udhëzohet të ndjekë punëtorinë mbi Mentorimin, të cilën e organizon Kolegji Heimerer.

Neni 6

Kufizimet për caktim të Co-Mentorit

6.1 Për të siguruar kualitetin e nevojshëm, Co-Mentori mund të angazhohet njëkohësisht:

- a) Në programet e nivelit Bachelor: në më së shumti 10 tema si Co-Mentor dhe të përcjellë 10 të tjera të propozuara si anëtar Komisioni;

ose

- b) Në programet e nivelit Master: në më së shumti 5 tema si Co-Mentor dhe të përcjellë 5 të tjera të propozuara si anëtar Komisioni.

6.2 Para se të marrë detyrën e Co-Mentorit për herë të parë, secili Co-Mentor udhëzohet të ndjekë punëtorinë mbi Mentorimin, të cilën e organizon Kolegji Heimerer.

Neni 7

- 7.1. Në rast se kërkesat për mentorim tejkalojnë numrin e kufizuar të mentorimeve të përcaktuar në Nenin 5 dhe 6 të kësaj Rregullore, atëherë Dekani i programit përkatës parashtron pranë Këshillit Akademik kërkesën e arsyetuar për angazhim të mentorëve të jashtëm.
- 7.2. Të gjitha dispozitat e kësaj Rregulloreje mbi kushtet, përgjegjësitë dhe kriteret e mentorimit, vlejnë dhe zbatohen edhe për mentorët e jashtëm.
- 7.3. Mënyra dhe forma e kompenzimit të mentorëve të jashtëm përcaktohet nga ana e Rektorit të BPrAL Kolegji Heimerer.

Neni 8

Konflikti i Interesit

8.1. Mentori, Co-Mentori dhe anëtarët e komisionit duhet të tërhiqen nga roli i përcaktuar në rastet e konfliktit të interesit, e përcaktuar si më poshtë:

8.1.1. Kur janë familjar ose kanë lidhje farefisnore me studentin.

8.1.2. Kur kanë afërsi miqësore apo të formave të tjera me studentin.

8.1.3. Në rast se vihet re afërsia emocionale me studentin gjatë procesit.

8.1.4. Nëse kanë përcjellur temën në nivelin Bsc, nuk u lejohet emërimi në temën Msc (nuk lejohet mentorimi serik).

8.2. Procedurat e ndërlidhura me Konfliktin e Interesit:

8.2.1. Mentori njofton Këshillin e Dekanatit me shkrim për konfliktin e interesit. Këshilli i Dekanatit pas vlerësimit përcakton mentor tjetër për temën përkatëse dhe së bashku me arsyetimin për ndërrimin e mentorit e prezanton në KA për miratim.

8.2.2. Pas vendimit për ndërprerjen e mentorimit, Mentori takon studentin për t'i sqaruar arsyen e ndërrimit të mentorit. Në këtë rast gjithë punën e realizuar deri në atë moment e përcjell tek mentori i dytë, të cilin sipas sipas nevojës e takon për sqarime shtesë.

8.2.3. Në rastet kur kërkesa e mentorit për ndërprerje të mentorimit është e pa bazë, atëherë Këshilli i Dekanatit ndonëse e refuzon kërkesën për ndryshim të Mentorit, emëron Co-Mentor për të përcjellur temën përkatëse.

8.3. Rreptësisht ndalohen përfitimet e çfardo forme, qofshin ato të Mentorit nga studenti. Në rastet kur vërtetohen shkeljet e tilla nga cilado palë e përfshirë, këto dëshmi dërgohen në Komisionin Etik dhe Disiplinor.

8.4. E njejta lëndë bashkë me arsyetimin dhe emërimin e Mentorit të ri dërgohet në KA për aprovim.

III. PUNIMI I TEMËS SË BACHELORIT/MASTER

Neni 9

9.1. Të gjitha programet e studimeve themelore të BPrAL Kolegji-Heimerer– Prishtinë, përfundojnë me punimin e Temës Bachelor/Master/MA.

9.2. Punimi i Diplomës për Bachelor/Master/MA është një punë e pavarur e studentit (çdo herë në konsulta me mentorin), përmes një projekti hulumtues (Studim rasti, eksperimentale, studime longitudinale, hulumtime kuantitative dhe kualitative e të tjera), të fushës së një studimi me

- karakter të përgjithshëm, i cili lidhet me një disiplinë të vetme shkencore, përmes implementimit të një ideje inovative apo edhe më shumë disiplina të përafërta, kur punimi ka karakter kompleks.
- 9.3. Punimi i diplomës për Bachelor/Master/MA, identifikon tema përkatëse për fushën e studimeve, paraqet njohuri relevante në lidhje me temën, mund të zhvillojë një ose më shumë pyetje kërkimore, kërkon reflektim mbi tezën dhe sqarim mbi rendësinë e saj, për profesionin përkatës.

Neni 10

- 10.1. Gjatë punimit të temës së diplomës, studenti është i obliguar që të konsultohet me Mentorin e lëndës, lidhur me formën, përmbajtjen dhe përfundimin e temës së diplomës;
- 10.1.1 Përgjegjësitë e studentëve:
 - 10.1.2. Të mos fillojnë punën në temë pa u konsultuar me mentorin paraprakisht;
 - 10.1.3. Të pajtohen për mënyrën e punës gjatë temës;
 - 10.1.4. Të respektojnë kohën dhe orarin e punës së mentorit;
 - 10.1.5. Të jenë vazhdimisht në kontakt me mentorin;
 - 10.1.6. Të takohen rregullisht sipas nevojës dhe kërkesës së mentorit;
 - 10.1.7. Të sillen në mënyrë etike dhe akademike gjatë komunikimit dhe takimeve;
 - 10.1.8. T'i përcjellin udhëzimet e mentorit;
 - 10.1.9. Të dorëzojnë punën e tyre kur dhe si kërkon mentorin;
 - 10.1.10. T'i përmirësojnë/adresojnë pjesët e rekomanduara nga mentorin;
 - 10.1.11. Të mos dorëzojnë temën pa u konsultuar me mentorin.
- 10.2. Përgjegjësitë e mentorit:
- 10.2.1. Të takojë studentin sipas orarit dhe kohës së caktuar;
 - 10.2.2. T'u përgjigjet kërkesave të studentit dhe të njoftojë kohën e përafërt për kthimin e komenteve;
 - 10.2.3. Të ofrojë vazhdimisht këshilla akademike dhe profesionale;
 - 10.2.4. T'i lexojë draftet e kapitujve të kompletuar;
 - 10.2.5. T'i dërgojë studentit komentet për çdo pjesë të dorëzuar nga studenti;
 - 10.2.6. Të mbajë kontaktin ndërmjet studentit dhe anëtarëve të komisionit për komentet për vlerësim të projekt propozimit dhe versionit final të temës.
- 10.3. Punimi i diplomës hartohet sipas kësaj Rregullore si dhe udhëzuesit të përpilimit të një teme, e cila është shtojcë e kësaj Rregulloreje, dhe të cilën studentët mund t'a tërheqin pranë Departamentit të Diplomave në çdo kohë.
- 10.4. Mentori i kandidatit e ka obligim të bëjë evidentimin e konsultave (shtojca bashkangjitur), të cilat i ka pasur me kandidatin rreth shtjellimit të temës relevante.

- 10.5. Pas përfundimit të të gjitha konsultimeve dhe finalizimit të temës së diplomës në dakordim me Mentorin dhe Qendrën e Shërbimeve për Studentë, studenti është i obliguar që të dorëzojë temën në departamentin e diplomave për miratim në Këshillin Akademik.
- 10.6. Pas miratimit të temës së diplomës nga Këshilli Akademik, së paku pesë ditë pune para mbrojtjes së temës dorëzohen pranë departamentit për diploma, tre (3) kopje fizike dhe një (1) kopje elektronike e punimit të diplomës. Kopjet duhet të jenë të lidhura në kopertina të forta, dhe të njejtat duhet protokolluar në librin e diplomimit të BPrAL Kolegji-Heimerer.

IV. PROCEDURA E MBROJTJES SË PUNIMIT TË DIPLOMËS

Neni 11

- 11.1. Komisioni për vlerësimin e Temës Bachelor, përbëhet nga tre anëtarë;
- 11.2. Njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë Mentori i studentit, ndërsa njëri nga dy anëtarët e tjerë duhet të jetë kryetari i komisionit.

Neni 12

- 12.1. Kryetari i Komisionit për vlerësimin e Temës Bachelor, fillimisht konstaton se a janë plotësuar kriteret në bazë të kësaj rregulloreje, për vlerësimin e temës, prezanton kandidatin para komisionit (cv e shkurtër).
- 12.2. Mentori i Kandidatit e bën një prezantim të shkurtër të temës për vlerësim para komisionit dhe pastaj fillon prezantimi i temës nga ana e kandidatit për diplomim.
- 12.3. Pas prezantimit të temës nga studenti, komisioni parashtron pyetje paraprake lidhur me temën, studenti i përgjigjet të gjitha pyetjeve të komisionit në fund.
- 12.4. Pas prezantimit anëtarët e komisionit e bëjnë vlerësimin individualisht dhe në fund merret vendimi i përbashkët i vlerësimit;
- 12.5. Në vendimin e vlerësimit caktohet edhe nota e Temës Bachelor/Master/MA;
- 12.6. Për notimin e temës, komisioni merr për bazë dokumentet për vlerësim (shtojcë në këtë rregullore).
- 12.7. Notimi mund të bëhet sipas kriterëve për vlerësim edhe në provime d.m.th. me notën: 5 (pesë), 6 (gjashtë), 7 (shtatë), 8 (tetë), 9 (nëntë), dhe 10 (dhjetë).
- 12.8. Kryetari i Komisionit në një ambient tjetër, në prani të anëtarëve të tjerë të komisionit me miratimin edhe të anëtarëve tjerë, e vendos notën dhe e nënshkruan vendimin për diplomim të studentit.
- 12.9. Mbrojtja e temës Master duhet të jetë publike (lista vendoset së paku tre ditë para mbrojtjes në buletin e institucionit) ndërsa për BSc në bazë të kërkesës së studentit (publike ose e mbyllur), mbrojtja e temës së diplomes bëhet brenda objektit të Kolegjit.

- 12.10. Pas parashtrimit të pyetjeve kryetari i komisionit mund të caktoj pushim për përgatitjen e përgjigjeve nga kandidati.
- 12.11. Nëse tema e diplomës është vlerësuar me notë të pamjaftueshme, atëherë kandidati duhet të plotësoj temën e diplomës dhe të eliminoj të metat e temës së diplomës, duke u bazuar në udhëzimet e kryetarit të komisionit dhe të vetë komisionit. Pastaj në afat 30 ditor përsëritet procedura e mbrojtjes së temës. Në rast se studenti dështon të mbrojë temën e diplomës për të dytën herë, atëherë aplikohet dispozita nga pika 11.12 e këtij neni.
- 12.12. Studentit që i është vlerësuar tema e diplomës me notë të pamjaftueshme mund të ndërroj temën e diplomës dhe mentorin jo më shumë se 2 herë.

V. NOTA MESATARE

Neni 13

- 13.1. Nota mesatare e studentit llogaritet sipas sistemit të legjislacionit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës;
- 13.2. Të gjitha notat e studentit të fituara gjatë viteve të studimeve së bashku me notën e Temës Bachelor/Master/MA, mbledhen dhe formojnë mesataren e përgjithshme.
- 13.3. Nota e temës së diplomës duhet vendosur në SIMS nga Mentori i Temës.

VI. LËSHIMI I DIPLOMËS

Neni 14

- 14.1. Studenti i cili e punon me sukses punimin e tij të Bachelor/Master/MA dhe merr notën kaluese (6, 7, 8, 9 apo 10) konsiderohet i diplomuar;
- 14.2. I diplomuari duhet të pajiset me dokumentin përkatës – Certifikaten e Diplomes, e cila nënshkruhet nga Rektori i Kolegjit Heimerer.
- 14.3. Diploma i lëshohet të diplomuarit në afat prej 4 (katër) javësh, nga dita e Diplomimit;
- 14.4. Diploma plotësohet qartë dhe nënshkruhet nga Rektori dhe Dekani i programit përkatës.

Neni 15

- 15.1. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari me nënshkrim dhe evidentohet në Librin e të diplomuarve.
- 15.2. Nëse prania e të diplomuarit është e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë vetëm personi që posedon autorizim notarial.

Neni 16

- 16.1. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i diplomuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë te pajiset me diplomë të përmirësuar.
- 16.2. Nëse personi tërheq diplomën me gabime apo në çdo rast kur i humbet ose dëmtohet origjinali duke i'u bërë e papërdorshme, atëherë Kolegji Heimerer mund të lëshoj diplomë dublikat. Diploma dublikat lëshohet sipas kushteve dhe procedurave në vijim:
- 16.3. Studenti duhet të shpallë të pavlefshme diplomën e humbur në njërën nga gazetatat ditore:
- 16.3.1. Ekstrakti nga gazeta ditore duhet të arkivohet në dosjen e studentit;
- 16.3.2. Në këndin e djathtë lartë shënohet shenja "DUPLIKAT", numri i protokollit dhe data e lëshimit (kjo mund të jetë edhe një vule që përmban këto të dhëna);
- 16.3.3. Të dhënat në diplomë përshkruhet dhe janë të njëjta me parapraken përveç shtimit të të dhënave nga pika e mësipërme.

Neni 17

Diploma e cila merret nga BPrAL Kolegji-Heimerer, me të cilën fitohet titulli Bachelor/Master i Shkencave apo profesionale, duhet të jenë në pajtim me formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe specifikat e tjera të përcaktuara në dispozitat e Udhëzimeve Administrative përkatëse të aprovuara nga strukturat shtetërore.

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Rektori i BPrAL Kolegji-Heimerer – Prishtinë.

Datë: 08/12/2021

Rektore e Kolegjit HEIMERER



Prof. Ass. Dr. Naime Brajshori